



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 114/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Hasan Shala dhe Nenad Lazić anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjeas Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Suharekë, për shkak të vendosjes se banerëve mbi rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 05.06.2014, mori këtë:

VENDIM

Miratohet si e bazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Suharekë, kështu që subjektit politik `Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Suharekë, i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 800 (tetëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Arsyetim

Me datën 03.06.2014 LVV dega në Suharekë ka parashtruar ankesë në PZAP me të cilën pretendon se me datën 02.06.2014 aktivistët er LVV-së në Suharekë diku rreth orës 11:00 kanë vërejtur se mbi rrugë publike ishte vendosur baneri i kandidatit të PDK-së Enver Hoxhaj. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bëre shkelje e Ligjit për zgjedhjet e përgjithshme dhe Rregullave Zgjedhore. Me këtë rast parashtruesi i ankesës si dëshmi ka bashkangjitur disa fotografji.

PZAP-i, e informoi subjektin politik PDK në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për ankesën që është bëre ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 05.06.2014, në ora 09:00.

Sipas afatit të caktuar, PZAP-i, mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik PDK në të cilën deklaron se posterat e kandidatit në fjalë janë hequr nga vendi ku kanë qenë të vendosura dhe se brenda afatit të paraparë është përmirësuar shkelja dhe si dëshmi ka bashkangjitur fotografat nga vendi i ngjarjes duke i larguar banerët nga vendi ku kanë qenë të vendosura ato.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se banerat e kandidatit për deputet nga radhët e subjektit politik PDK Enver Hoxhaj janë të vendosura mbi rrugët publike , e që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike.

Për përcaktimin e lartësisë së gjobës të vendosur në dispozitiv të këtij vendimi PZAP-i, ka marrë parasysh faktorët në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

PZAP-i, mori parasysh të gjitha rrethanat si rëndësuese ashtu edhe rrethanat lehtësuese. Si rrethanë rënduese mori se subjekti politik PDK ka marr pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara dhe se është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe faktin se banerat e kandidatit të saj për deputet kanë qenë të vendosur në vendin e palejuar për vendosjen e tyre. Ndërsa si rrethanë lehtësuese PZAP-i mori se subjekti politik PDK, pas marrjes së kërkesës përgjigje në ankesë nga PZAP-i, brenda afatit të caktuar, ka ndërmarr veprime të dukshme për evitim e shkeljes duke i larguar menjëherë banerat nga vendi ku ka ndodhur shkelja.

PZAP-i duke marr parasysh të gjitha arsyet e lartcekura se nga ana e subjektit politik PDK është shkelur neni 33 pika b) të LZP-së, pasi që banerat e kandidatit të saj janë vendosur mbi publike, si dhe duke pasur parasysh veprimet e menjëhershme të subjektit politik PDK që ka ndërrmar për evitim e shkeljes si dhe përpjekjet për të parandaluar veprimet e ndaluara në bazë të provave të cilat i ka ofruar të bashkangjitura përgjigjes në ankesë e të cilat veprime kanë ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptua, PZAP-i në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 114/2014 më datën 05.06.2014.

Kryesuesi i Panelit

Xhevdi i Abazit



Prishtine / Prishtina

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.